VENDIM
Nr. 32, datë 26.3.2012

PËR DHËNIE LICENCE PËR RADION PRIVATE VENDORE "RADIO MOTIV"
SUBJEKTIT: SHOQËRIA "MEDIA MOTIV" SHA

Në mbështetje të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, rregullores "Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim radioteleviziv analogjik tokësor në nivel vendor", miratuar me vendimin nr. 355 pika 1, datë 29.8.2005 të KKRT-së, rregullores "Kriteret për dhënien e licencave për transmetime televizive dhe radio FM analoge tokësore në nivel vendor", miratuar me vendimin nr. 355 pika 2, datë 29.8.2005 të KKRT-së, dhe rregullores "Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë", miratuar me vendimin nr. 1, datë 29.1.2010 të KKRT-së, pasi mori në shqyrtim kërkesën e shoqërisë "Media Motiv" sh.a., për t'u licencuar si operator radiofonik privat vendor dhe mbështetur në propozimin e komisionit të shqyrtimit të dokumentacionit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T'i japë shoqërisë "Media Motiv", sh.a., licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator radiofonik vendor privat për "Radio Motiv", në fushën e transmetimeve tokësore analogjike për një periudhë prej 3 (tre) vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal rrethin e Shkodrës.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati